

# EDICIONI I DYTË VJETOR I ÇMIMIT PËR MEDIA TË PCI-SË

## Thirrje për aplikime

### Hyrje

Pjesa më e madhe e publikimeve në media në Serbi dhe Kosovë për 'anën tjetër' janë në përgjithësi dhe kryesisht negative. Storit për jetën e përditshme dhe bashkëjetesën paqësore mbeten të patreguara. Për dy kombet fqinje, një narrativ i vazhdueshëm përçarës vetëm riprodhon dhe forcon perceptimet dhe paragjykimet aktuale negative. Shumë storie jashtë këtij narrativi mbizotërues marrin fare pak vëmendje.

Nisma për Ndryshim Paqësor (shkurt PCi, nga gjuha angleze *Peaceful Change initiative*), si pjesë e një projekti të financuar nga qeveria e Mbretërisë së Bashkuar, porositi një studim kërkimor nga IPSOS Strategic Marketing në temën "Kuptimi i narrativave përçarëse – Analizë e mediave në Serbi dhe në Kosovë" ([Vegëza e studimit](#)). Kjo analizë demonstroi se mediat në Serbi dhe në Kosovë "marrin pjesë në procesin e 'tjetërsimit' ndërmjet dy entiteteve".

Për t'iu kundërvënë këtyre trendeve dhe për vitin e dytë me radhë, PCi ndan çmime që do të çmojnë dhe shpërblejnë përmbajtjen mediatike që ofron një pamje ndryshe në lidhje me realitetet e përditshme të jetës në Serbi dhe në Kosovë. Ky çmim çmon dhe shpërblen si gazetarët ashtu edhe mediat.

## ÇMIMI PËR MEDIA

### Objektivi

Qëllimi i Çmimit për Media është promovimi dhe shpërblimi i përmbajtjes mediatike nga Kosova dhe Serbia që eksploron tema në lidhje me bashkëjetesën e komuniteteve.

### Temat

Çmimi për Media do të çmojë dhe do të shpërblejë përmbajtjen e shquar mediatike që eksploron një nga temat e mëposhtme ose një kombinim të këtyre:

- Bashkëjetesa shumetnike

Pavarësisht nga trendi aktual gazetaresk në Kosovë dhe në Serbi për të përdorur një portretizim thjesht bardhë e zi të 'tjetrit', jeta ofron shumë nuanca jo vetëm gri, por të një palete të tërë ngjyrash që vërtetojnë se bashkëjetesa shumetnike nuk është thjesht e mundur por një realitet.

- Realitetet e përditshme të jetës për një komunitet të veçantë në një vend të veçantë  
Të qenët një komunitet pakicë portretizohet në mënyrë implicite në media si një disavantazh, por a është vërtet kështu? A mund një komunitet pakicë të përparojë dhe të lulëzojë në mesin e shumicës 'tjetër'?

- Të përbashkëtat e jetës së përditshme për komunitetet në Serbi dhe në Kosovë  
Shumë shpesh, problemet e një komuniteti portretizohen si unike dhe shpesh për to i hidhet faji 'tjetrit'. Në realitet, shumica e problemeve me të cilat përballen të dy komunitetet janë të njëjta: shërbimet e dobëta publike, papunësia, pasiguria e punës, pandemia e COVID-19, pasojat e luftës në Ukrainë, etj. Theksimi i aspekteve të përbashkëta të jetës së përditshme ndihmon ndryshimin e perceptimeve të mishëruara negative për 'tjetrin'.

## Formatet

Duke pasur parasysh objektivin specifik, çmimet e ndara do të shpërblejnë përmbajtjen mediatike në formatet e mëposhtme:

- Audioviziv (duke përfshirë storie në TV, dokumentarë, video në media sociale, storie në radio, podcaste, intervista, dhe jo vetëm këto).
- I shkruar (duke përfshirë artikuj në gazeta, artikuj në revista, ueb-lajme, ueb-storie, storie në portale online, storie personale dhe blog, storie në media sociale, dhe jo vetëm këto).

## Shpërblimi

Kategoria e shpërblimit sipas formatit		Çmimi për Gazetarë (për gjuhën shqipe)	Çmimi për Gazetarë (për gjuhën serbe)	Çmimi për Media (për gjuhën shqipe)	Çmimi për Media (për gjuhën serbe)
Audioviziv	Çmimi i 1-rë	2.000€	2.000€	1.000€	1.000€
I shkruar	Çmimi i 1-rë	2.000€	2.000€	1.000€	1.000€
Audioviziv	Çmimi i 2-të	500€	500€	N/A	N/A
I shkruar	Çmimi i 2-të	500€	500€	N/A	N/A
Audioviziv	Çmimi i 3-të	300€	300€	N/A	N/A
I shkruar	Çmimi i 3-të	300€	300€	N/A	N/A

## Pranueshmëria

Çmimi për Media është i hapur për aplikime nga të gjitha mediat (TV, radio, ueb). Aplikuesit mund të jenë gazetarë, përfaqësues të mediave, organizata dhe/ose individë të pavarur që kanë krijuar përmbajtje në lidhje me Temat e Çmimit dhe i kanë publikuar ato në një media të njohur (jo vetëm në uebsajtin personal të një individi, faqen e mediave sociale, blog, etj.) brenda periudhës së caktuar kohore të Çmimit (**1 janar 2022 – 31 janar 2023**).

Kushtet për përmbajtjen e dorëzuar:

- Të ofrohet vetëm përmbajtje mediatike që është publikuar përpara dërgimit të formularit të aplikimit;
- Të jetë shkruar dhe publikuar në gjuhën shqipe dhe/ose serbe;
- Të tregojë storie që fokusin e kanë në Serbi dhe/ose në Kosovë;
- Të jetë publikuar ndërmjet datave 1 janar 2022 dhe 31 janar 2023.
- Të jetë në formatin e shkruar një storie e vetme dhe jo një seri e storieve.

## **Procesi i dorëzimit të aplikimeve**

Të gjitha aplikimet duhet të bëhen përmes formularit të aplikimit të dhënë online: <https://forms.gle/1cp7dkz7NnttwLE69>.

Afati i fundit për dorëzim të aplikimeve është **1 shkurt 2023**. Çdo pyetje e mundshme në lidhje me çmimin mund të drejtohet këtu [media.award@peacefulchange.org](mailto:media.award@peacefulchange.org).

### **Kriteret e përzgjedhjes**

Juritë e çmimit do të përzgjedhin fituesit duke u bazuar në kriteret e mëposhtme:

- Relevanca me temën.
- Stili dhe cilësia.
- Veçoria unike.
- Çështjet e trajtuara.
- Zërat njerëzorë.

### **Leja për ritransmetim dhe/ose ripublikim**

Të gjithë aplikuesve u kërkohet të bien dakord që përmbajtja e tyre mediatike të ri-shpërndahet në uebsajte dhe/ose media të tjera.